



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/99
Datë: 30.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Falimentimit.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde / Ministry of Justice

KONCEPT DOKUMENTI
PËR FUSHËN E FALIMENTIMIT

Qershor 2022

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e koncept dokumentit	Error! Bookmark not defined.
Hyrje	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 1: Ligji i ri për Falimentimin: Përparësitë e tij dhe sfidat	6
Kapiutlli 1.1 Problemet kryesore me Ligjin për Falimentimin	11
Kapiutlli 1.2 Shkaqet	12
Kapiutlli 1.3 Efektet.....	14
Kapitulli 2: Objektivat	20
Kapitulli 3: Opsionet	21
Kapiutlli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim.....	21
Kapiutlli 3.2: Përmirësimi i Implementimit të Kornizës Aktuale Ligjore	23
Kapiutlli 3.3: Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit për Falimentimin	25
Kapitulli 4: Identifikimi dhe Vlerësimi i Ndikimeve të Ardhshme	35
Asnjë ndikim.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	38
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	40
Kapiutlli 6.2:Krahasimi i tri opsioneve.....	42
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	44
Kapiutlli 7.1: Dispozitat për Monitorim dhe Vlerësim	44
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për Ndikimin Ekonomik	45
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për Ndikimet Shoqërore.....	48
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për Ndikimet Mjedisore	52
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për Ndikimet në të Drejtat Themelore	55
I. Vlerësimi i relevancës gjinore	57
Hapi 1 Përkufizimi i Qëllimit të Politikës	57
II. Vlerësimi i ndikimit gjinor	63
Hapi 3 Analizat e ndjeshme gjinore	63

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informata të përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Fushën e Falimentimit
Ministria bartëse	Ministria Drejtësisë
Personi kontaktues	Ruzhdi Osmani, Kryesues i ekpit punues, Zv. Drejtor, DIEKP, MD
PSO	Koncept Dokumenti të përshihet në planin vjetor të punës së MD-së të vitit 2022
Prioriteti strategjik	<ul style="list-style-type: none">- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit (PKZMSA) 2022-2026 ,- Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026- Plani Zhvillimor Strategjik i MD

Vendimi	
Çështja kryesore	<p>Mangësitë e Ligjit për Falimentimin, i aprovuar në vitin 2016, kanë ndikuar në nivelin e ulët të besimit dhe mbështetjes së bizneseve në sistemin e falimentimit. Kufizimet e shqiptuara ndaj bizneseve pas përfundimit të procedurave të falimentimit, ashtu siç është përcaktuar në seksionin e parimeve të përgjithshme, janë tepër të rrepta për të tejkaluar stigmën kulturore ekzistuese ndaj procedurave të falimentimit. Në rastet e riorganizimit, kriteret ligjore për të dorëzuar një kërkesë të riorganizimit për të filluar një rast kundër një debitori të pranueshëm janë shumë kërkuese. Në rastet e likuidimit, mungesa e kriterëve të qarta që Administratorët e Falimentimit duhet të ndjekin për të maksimizuar kthimet e përgjithshme të kreditorëve, krijon paqartësi për bizneset.</p> <p>Ligji për Falimentimin gjithashtu nuk ofron një bazë ligjore për të krijuar një autoritet të pavarur mbikëqyrës i cili mbikëqyr funksionimin e sistemit, si dhe implementimin e legjislacionit dhe aktivitetin e Administratorëve të Falimentimit. Niveli i ulët i besimit në sistemin e falimentimit korrespondon me numrin jashtëzakonisht të vogël të aplikimeve për falimentin në gjykata. Që nga miratimi i ligjit në vitin 2016, vetëm shtatëmbëdhjetë raste deri më tani janë dorëzuar. Koncept Dokumenti gjithashtu identifikon faktorët përtej ligjit të cilat përkeqësojnë efektivitetin e regjimit të falimentimit. Pas një analize gjithëpërfshirëse, Koncept</p>

	Dokumenti rekomandon amendimin e Ligjit për Falimentimit si opsioni i preferuar për të rritur efektivitetin e regjimit të falimentimit në Kosovë.
Përmbledhje e konsultimeve	[Renditni këtu konkluzionet kryesore nga procesi i konsultimit ndërministror që u realizua për Koncept Dokumentin. Nëse nuk ka mosmarrëveshje me ministritë e tjera të linjës ose kur janë adresuar të gjitha mosmarrëveshjet fillestare, deklaroni qartë këtë. Nëse mosmarrëveshjet mbesin, renditni këtu dhe tregoni pse këto nuk janë tejkaluar.]
	[Renditni aktivitetet kryesore të konsultimit publik që janë realizuar. Shënoni edhe datën e fillimit dhe datën e mbarimit të konsultimit publik online me shkrim. Shënoni numrin e organizatave që kanë dhënë përgjigje për këtë konsultim, numrin e komenteve të marra dhe konkluzionet kryesore nga procesi i konsultimit publik. Referojuni raportit mbi konsultimin publik që duhet të paraqitet së bashku me Koncept Dokumentin për miratim nga Qeveria.]
Opsioni i propozuar	Grupi i Punës, pas konsultimit, analizës dhe identifikimit të problemeve të Ligjit aktual, konsideron se opsioni tre për ndryshimin e Ligjit për Falimentim është më i përshtatshëm dhe më i pranueshëm për zgjidhjen përfundimtare dhe të qëndrueshme të problemit kryesor.]

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	[Deklaroni ndikimin në buxhet. Nëse opsioni i propozuar mbulohet nga pragu aktual buxhetor, deklaroni “implementohet nga pragu aktual buxhetor’.]
Ndikimet ekonomike	Efektshmëria e falimentimit komercial dhe regjimi i rikuperimit të borxhit ndikon në klimën e investimeve dhe në rritjen ekonomike.
Ndikimet shoqërore	Siguria e vendeve të punës do të forcohet; të drejtat e punëtorëve do të mbrohen më mirë
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektoriale	Regjimi i efektshëm i falimentimit është një bazë e mirëfilltë ku takohen sundimi i ligjit dhe rritja ekonomike
Ngarkesat administrative për kompanitë	Ndryshimet e ligjit do të riorganizojnë fillimin e proceduarve të falimentimit, rrjedhimisht do të lehtësohen ngarkesat për debitorët dhe kreditorët për qasje në gjykata.

Testi i NVM-ve	Po
----------------	----

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	1. Hartimi i një Draft Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Falimentim
Afatmesëm	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prioritizimi i rasateve të falimentimit në gjykata; 2. Rritja e mundësive të zhvillimit profesional për profesionistët ligjor të ligjit të falimentimit; 3. Konsolidimi i profesionit të Administratorëve të Falimentimit; 4. Themelimi i një autoriteti për mbikqyrjen administrative të falimentimit; 5. Shtrirja tek palët e interesit dhe ngritja e vetëdijesimit

Hyrje

Tabela 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Fushën e Falimentimit
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë
Personi kontaktues	Ruzhdi Osmani, Zv. Drejtor i Departamentit për Integrim European dhe Kordinim të Politkave, Ministria e Drejtësisë
PSO	Koncept Dokumenti të përfshihet në planin vjetor të punës për vitin 2022
Prioriteti strategjik	<ul style="list-style-type: none"> - Programi Kombëtar për Implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim, Blloku 2: Kriteri Ekonomik; - Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021), Nën-Objektivi 1.1 Reformat për legjislacionin ekzistues primar dhe sekondarë për rritjen e konkurrueshmërisë
Grupi punues	<p>Përfaqësues të mposhtme të ministrive të linjës, agjencive dhe profesioneve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ruzhdi Osmani, Zv. Drejtor, DIEKP, Ministria e Drejtësisë, Kryesues; - Rexhep Bllaca, Drejtor, Departamenti Ligjor, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe, Zëvendës Kryesues; - Eros Gashi, Këshilltar Politik i Ministres së Drejtësisë

	<ul style="list-style-type: none"> - Labinot Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Jurisprudence, Ndërmjetësim dhe Administrator Falimentues - Isuf Jahmurataj, zyrtar i lartë ligjor, DL - Trëndelina Qorraj, Zyrtare e Lartë për Integrim Evropian, DIEKP - Hajrie Zogaj, Zyrtare e Financave, Divizioni për Buxhet dhe Financa - Albulena Uka, Zyrtare e Lartë, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Profesioneve të Lira - Mahir Tutuli, Gjyqtar, Gjykata e Apelit, KGJK - Albert Selimi, zyrtar i lartë për kordinim të politikave, SKQ, ZKM - Albërita Hyseni, zyrtare e lartë ligjore, Zyra Ligjore, ZKM - Gëzim Bislimi, analist i lartë i buxhetit, MFPT - Mehmet Berisha, Oda e Administratorëve Falimentues - Përfaqësues nga Odat Ekonomike në Kosovë - Syzana Dautaj, eksperte, IFC - Njomëza Zejnullahu, Eksperte
Informata shtesë	Hartimi i këtij koncept dokumenti është mbështetur nga Projekti për Zgjidhjen e Borxhit Faza II, financuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare.

Kapitulli 1: Ligji i ri për Falimentim: Përparësitë dhe sfidat e tij

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ka 213,739 biznese të regjistruara.¹ Që nga miratimi i Ligjit të ri për Falimentimin në vitin 2016, megjithatë, vetëm shatëmbëdhjetë (17) raste të falimentimit² janë inicuar në Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili mban juridiksionin ekskluziv për të trajtuar regjistrimet e falimentimit. Ky Koncept Dokument identifikon dhe analizon bazën që shpjegon numrin e ulët të aplikimeve për falimentim, dhe në vijim propozon një portofol të opsioneve për të rritur aplikimet e falimentimit të cilat inkurajojnë aktivitetin e shëndetshëm të biznesit dhe parandalojnë tronditjet financiare agregate në ekonominë e Kosovës.

Efektiviteti i falimentimit komercial dhe regjimeve të rikuperimit të borxhit ndikon në klimën e investimeve dhe rritjen ekonomike. Kornizat efektive dhe rregullative ligjore

¹ Shih <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,1>

² Të dhënat përditësuara deri më 24 shkurt, 2022: 2018 (3 raste); 2019 (2raste); 2020 (1 rast); 2021 (8 raste); 2022 (3 raste – deri në muajin shkurt, 2022)

zvogëlojnë rrezikun e kredisë, si dhe stimulojnë kreditorët të japin hua më shumë dhe me kamatë më të ulët. Një qasje sistematike ndaj falimentimit dhe rikuperimit të borxhit lehtëson daljen e biznesit pas vështirësive, sugjeron sigurimin e planeve të riorganizimit që krijojnë besim midis kreditorëve, debitorëve dhe punonjësve, ose zgjidh në mënyrë efektive mosmarrëveshjet tregtare midis debitorëve dhe kreditorëve.

Para vitit 2016, Kosova konsiderohej se nuk kishte praktikë falimentimi. Ndërsa 99% e bizneseve të Kosovës klasifikohen si NVM, korniza rregullatore e falimentimit para vitit 2016 ishte e zbatueshme vetëm për korporatat. Kosova nuk kishte raste të riorganizimit ose likuidimit të suksesshëm, duke theksuar vështirësinë që përballen kreditorët për tu rikuperuar pasi se biznesi të falimenton. Miratimi i Ligjit për Falimentimin në vitin 2016 zgjeroi fushën e aplikimit të procedurave të falimentimit dhe e zhvendosi Kosovën nga një vend pa kornizë ligjore për procedurat e falimentimit në një vend me procedura të likuidimit të përcaktuara mirë për t'i dhënë fund me përgjegjshmëri një biznesi ose procedurat e riorganizimit për të rikthyer një biznes. Sidoqoftë, Ligji i ri nuk e gjeti ekosistemin e biznesit të përgatitur për të përdorur ligjin si një mjet për të ruajtur asetet e kompanisë, kreditorët dhe ekonominë në përgjithësi.

Reformat e ndërmarra përmes Ligjit për Falimentim të vitit 2016 u pasqyruan pozitivisht në *Raportin e Bërjes së Biznesit* të Bankës Botërore të vitit 2018, duke lëvizur renditjen globale të Kosovës në treguesit e falimentimit nga pozicioni 163 në 48 për përmirësimet në zgjidhjen e falimentimit.³ Ligji për Falimentimin rregullon si aspektet thelbësore ashtu edhe ato procedurale të procedurave të falimentimit, duke përcaktuar likuidimin dhe riorganizimin dhe duke prezantuar procedura vijuese për debitorët dhe kreditorët.

Ligji për Falimentimin është i zbatueshëm për bizneset – pronarë të vetëm, partneritete të përgjithshme, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe kompani me aksione – siç përcaktohet në Ligjin për Organizimin e Bizneseve. Ligji për Falimentim nuk rregullon procedurat e falimentimit për institucionet financiare, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensioneve, Ndërmarrjet me Pronësi Shoqërore dhe Ndërmarrjet Publike, të cilat rregullohen me ligje të tjera. Sidoqoftë, entitete të tilla mund të veprojnë si kreditorë në procedurat e përcaktuara me Ligjin e Falimentimit.

Ligji për Falimentim përcjell standardet dhe praktikën e mëdha ndërkombëtare të përcaktuara nga Parimet e Bankës Botërore për Falimentimin Efektiv dhe

³ See <http://www.doingbusiness.org/reforms/overview/economy/kosovo>

Kreditorët/Regjimet e Borxhit,⁴ dhe Udhëzuesin Legjislativ për falimentim UNCITRAL⁵, të cilat janë dy instrumente që vendosin standardin e Bordit të Stabilitetit Financiar⁶ për ligjin e falimentimit. Dokumente shtesë që diskutojnë gjithashtu rëndësinë e falimentimit dhe reformën janë Plani i Veprimit G20 për Financimin e NVM-ve,⁷ Strategjia e Tregut të Përbashkët të Komisionit të BE-së,⁸ dhe Rekomandimi i Komisionit të BE-së për vitin 2014 për një qasje të re ndaj dështimit të biznesit dhe falimentimit⁹.

Risia e ligjit të ri është prezantimi i një kapitulli të vetëm për procedurat e shpejtuara të falimentimit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) (Kapitulli 2 i Ligjit për Falimentim). Neni 12 përcakton se çështjet që përfshijnë një debitor të NVM-ve duhet të trajtohen si një rast riorganizimi, duke i dhënë mundësinë NVM-ve të paraqesin një plan riorganizimi brenda 30 ditëve nga fillimi i procedurave të falimentimit. Paraqitja e planeve të para-dakorduara për NVM-të u jep debitorëve mundësinë për të negociuar me kreditorët për lehtësimin e borxhit edhe para fillimit të procedurave të falimentimit dhe, më pas, të kërkojnë menjëherë nga gjykata që të konfirmojnë planin (neni 16 dhe 17).

Inkurajimi i riorganizimit në një periudhë relativisht të shkurtër kohore është prezantuar për të adresuar vështirësitë e NVM-ve në lidhje me efektet e falimentimit, si një pengesë për veprimtarinë sipërmarrëse¹⁰. Përgjatë procedurave të riorganizimit, gjykata cakton gjithashtu një monitorim në mesin e administratorëve të falimentimit për të shërbyer si këshilltar i debitorit në përgatitjen e një plani ekonomikisht të mundshëm të riorganizimit (neni 13). Pas konfirmimit të një plani të riorganizimit, neni 13 thotë se një debitor i NVM gjithashtu merr një shkarkesë. Dispozita e shkarkimit nënkupton që NVM-të gëzojnë një afat ligjor për të marrë një shkarkesë, i cili është një nxitje mikpritëse për të shpejtuar përfundimin e procedurave të falimentimit.

Futja e debitorit në pronësi, ku debitori vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e biznesit me fillimin e procedurës, është një tjetër parim për të demonstruar besim tek debitori dhe për të minimizuar stigmën e dështimit të biznesit gjatë procedurave të falimentimit. Shërbimi

⁴ See <http://pubdocs.worldbank.org/en/919511468425523509/ICR-Principles-Insolvency-Creditor-Debtor-Regimes-2016.pdf>

⁵ See <https://www.uncitral.org/pdf/english/texts/insolven/1997-Model-Law-Insol-2013-Guide-Enactment-e.pdf>

⁶ https://www.fsb.org/2011/01/cos_051201/

⁷ See <https://www.gpfi.org/publications/g20-action-plan-sme-financing-implementation-framework>

⁸ See https://ec.europa.eu/growth/single-market/strategy_en

⁹ See <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014H0135&from=EN>

¹⁰ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions - Upgrading the Single Market: more opportunities for people and business (COM (2015) 550 final).

si debitor në pronësi gjatë riorganizimit është gjendja e paracaktuar, përveç nëse debitori ka kryer mashtrim, nuk mund të menaxhojë çështje financiare, ose kreditorët nuk i besojnë debitorit (neni 66). Futja e debitorit në pronësi si gjendje e paracaktuar duhet të inkurajojë fillimin e procedurave të falimentimit si një mjet ligjor për lehtësimin e biznesit, sesa si konfirmim për dështimin.

Roli i administratorëve të falimentimit në procedura është fleksibël, në varësi të rrethanave të një rasti të riorganizimit. Administratorët e falimentimit mund të veprojnë si përfaqësues i pasurive kur debitorët në pronësi largohen nga gjykata ose si mentor kur debitorët shërbejnë si debitorë në pronësi (neni 7, neni 66). Në procedurat e likuidimit, Administratorët e Falimentimit veprojnë si përfaqësues të pasurive.

Pavarësisht përmirësimeve të rëndësishme në regjimin e falimentimit për shkak të Ligjit të ri për Falimentim, mangësitë kryesore të këtij ligji kanë mirëmbajtur nivelin e ulët të besimit dhe mbështetjen e bizneseve në sistemin e falimentimit. Nën-seksioni i mëposhtëm identifikon fushat e ligjit të cilat janë problematike dhe, nga ana tjetër, kanë penguar bizneset të mbështeten në falimentim.

Situata me Pandeminë COVID-19

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 e detyroi sistemin gjyqësor të Kosovës që të përshtatë funksionimin e sistemeve të tyre gjyqësore me rrethanat e reja për të siguruar përmbushjen e të drejtës për shëndet dhe mbrojtjen e të drejtës për jetë. Duke marrë parasysh pasojat në operacionet e biznesit, ka të ngjarë që pandemia të ketë ndikimin e saj edhe në falimentim. Megjithatë, krizat e mëparshme kanë treguar se çështjet e aftësisë pagueuse, mospagesat e borxhit dhe krijimi i kredive me probleme mund të duhen disa tremujorë për të arritur kulmin. Megjithatë, sipas statistikave të marra nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Ekonomike, vërehet një rritje domethënëse në numrin e rasteve të inicuar të falimentimit. Më poshtë paraqitja tabelare e rasteve të falimentimit sipas viteve:

Viti	Numri i rasteve të inicuar të falimentimit
2018	3
2019	2
2020	1
2021	8
2022 ¹¹	3

Themelimi i Gjykatës Komerciale

Pas tre viteve të mbështetjes intensive nga donatorët, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin që do të krijojë një Gjykatë të specializuar Komerciale. Ligji krijon një gjykatë të specializuar për të trajtuar çështjet komerciale, duke zëvendësuar strukturat e dobëta të menaxhimit dhe proceset e rrjedhës së punës që rezultojnë në shqyrtimin e këtyre çështjeve me vite. Gjykata e re Komerciale ka Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë. Vendimet e Dhomës së shkallës së Dytë do të kenë të njëjtën fuqi me vendimet e Gjykatës së Apelit. Dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale përbëhen nga katër (4) Departamente të veçanta, duke përfshirë Departamentin e Çështjeve Ekonomike, Departamentin Fiskal, Departamentin e Çështjeve Administrative dhe Departamentin e

¹¹ Sipas të dhënave të muajit shkurt, 2022

Përgjithshëm. Ndër kompetencat e Gjykatës Komerciale pa dyshim se ka edhe riorganizimi, falimentimi dhe shuarjen e shoqërive tregtare. Ligji për Gjykatën Komerciale ka dispozitë të veçantë që të gjitha veprimet në procedurat e falimentimit do të trajtohen me prioritet dhe në përputhje me afatet e parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi, e që në këtë rast është Ligji për Falimentimin. Pra, me ardhjen e Gjykatës Komerciale, domosdo kërkohet ndryshimet e ligjit të tanishëm për falimentim në përgjigje të nevojave të bizneseve siç janë paraqitur tek shkaqet dhe në fund opsionet si më poshtë.

Kapitulli 1.1 Problemet kryesore me Ligjin për Falimentim

Mangësitë e Ligjit për Falimentimin kanë ruajtur nivelin e ulët të besimit dhe mbështetjes së bizneseve në sistemin e falimentimit. Kufizimet pas falimentimit për bizneset, siç thuhet në seksionin e parimeve të përgjithshme, janë tepër të rrepta për të kapërcyer stigmën ekzistuese kulturore drejt procedurave të falimentimit. Testi i fillimit është i vështirë për tu përmbushur si për debitorët ashtu edhe për kreditorët dhe një thjeshtësim i kërkesave për të filluar një çështje falimentimi duhet të merret parasysh. Gjithashtu, duhet të merret parasysh zgjerimi i fushës së zbatimit të ligjit përtej numrit relativisht të vogël të subjekteve për të cilët ai zbatohet sot. Në rastet e riorganizimit, kriteret ligjore për të paraqitur një petition të riorganizimit për të filluar një rast kundër një debitori të pranueshëm janë shumë kërkuese. Në rastet e likuidimit, mungesa e kriterëve të qarta që Administratorët e Falimentimit ndjekin për të maksimizuar kthimin e përgjithshëm të kreditorëve krijon paqartësi për bizneset që të fillojnë procedurat e likuidimit. Ligji për Falimentimin gjithashtu nuk ofron një bazë ligjore për krijimin e një autoriteti të pavarur mbikëqyrës i cili mbikëqyr funksionimin e sistemit, si dhe zbatimin e legjislacionit dhe veprimtarinë e administratorëve të falimentimit. Niveli i ulët i besimit në sistemin e falimentimit korrespondon me një numër jashtëzakonisht të vogël të aplikimeve të falimentimit në gjykata. Që nga miratimi i ligjit në vitin 2016, janë ngritur vetëm katër raste: një çështje është mbyllur për shkak të mungesës së pasurive të debitorit, një çështje tjetër është refuzuar nga gjykata, dhe vetëm dy raste konsiderohen të vazhdueshme. Koncepti Dokumenti gjithashtu identifikon faktorët përtej ligjit që përkeqësojnë efektivitetin e regjimit të falimentimit. Shkaqet e identifikuara në Kapitullin 1.2 dhe efektet e shoqëruara në Kapitullin 1.3 shpalosin më tej gjendjen aktuale të sistemit të falimentimit.

Kapitulli 1.2 Shkaqet

Shkaku 1.2.1 Kërkesat ligjore për dorëzimin e një rasti të falimentimit dhe fushëveprimi i aplikimit të ligjit: kriteret sipas Ligjit për Falimentimin për të dorëzuar një kërkesë të riorganizimit për fillimin e rastit kundër një debitori të pranueshëm janë shumë kërkuese. Sipas Ligjit për Falimentim, rastet e falimentimit mund të iniciohen vetëm nëse të paktën dy kreditorë paraqesin një kërkesë njëkohësisht. Praktika ka treguar që për shkak të mentalitetit ose marrëveshjes me një debitor, është sfiduese që dy kreditorë të paraqesin një kërkesë njëkohësisht. Kjo kërkesë është një pengesë në procedurat e falimentimit dhe mund të adresohet vetëm me ndryshimin e ligjit dhe heqjen e një kërkesë të tillë. Formalitetet e kërkuara mund të jenë të tepërta për një ekonomi relativisht informale, siç është rasti i Kosovës. Dhe në fund, fushëveprimi i zbatimit të ligjit mund të forcohet më tej, në atë mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm edhe për ndërmarrësit e paregjistruar. Në të kundërtën, shumica e mikro-ndërmarrësve nuk përfitojnë nga përdorimi i sistemit të falimentimit, i cili është një nga dobësitë kryesore të ligjit aktual.

Shkaku 1.2.2 Mungesa e kriterëve për të siguruar maksimizimin e kthimit të debitorëve dhe aspektet e tjera ku Ligji ka treguar përgjigje të pamjaftueshme: Administratorët e falimentimit janë përgjegjës për organizimin e shitjes së pasurive në procedurën e likuidimit; sidoqoftë, nëse çmimi minimal nuk mund të vendoset në nivelin e borxhit, Administratorët e Falimentimit mund të anashkalojnë procedurat e ofertës publike dhe të shesin pasuritë me çmimin më të lartë të ofruar në treg. Mungesa e kriterëve sipas Ligjit për Falimentimin kur procedurat e ofertës publike nuk ndiqen, jep kompetencë të padrejtë, diskrecionuese mbi Administratorët e Falimentimit. Anashkalimi i procedurave të ofertës publike pa kriterë të qarta për t'u ndjekur në kthim mund të rrezikojë maksimizimin e kthimit të përgjithshëm të kreditorët. Disa aspekte të ligjit gjithashtu mund të rishikohen për të rritur kthimin e kreditorëve dhe perspektivat e një kompanie për t'u riorganizuar. Këto përfshijnë, për shembull, trajtimin e kontratave në ligjin aktual dhe mungesën e një procedimi të plotë të para-falimentimit për të inkurajuar aplikimet në kohë, në përputhje me Direktivën e fundit të BE-së 2019/1023 mbi kornizat parandaluese të ristrukturimit.¹² Ngjashëm, prezantimi i një trajtimi më të shpejtë të falimentimit të Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla përgjatë diskutimeve aktuale ndërkombëtare për trajtimin e falimentimit të NMMV¹³ mund të inkurajojë përdorimin e mëtejshëm të sistemit të falimentimit.

¹² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L1023&from=EN>

¹³ <http://documents.worldbank.org/curated/en/973331494264489956/pdf/114823-REVISED-PUBLIC-MSME-Insolvency-report-low-res-final.pdf>

Shkaku 1.2.3 Mungesa e Autoritetit Mbikëqyrës: Ligji për Falimentim nuk ofron një bazë ligjore për krijimin e një autoriteti të pavarur mbikëqyrës. Kosova nuk ka një organ të veçantë përgjegjës për trajtimin e çështjeve administrative dhe mbikëqyrëse që kanë të bëjnë me praktikën e falimentimit, në përgjithësi, dhe Administratorët e Falimentimit, në veçanti. Zhvillimi i praktikës së falimentimit varet nga krijimi i një autoriteti efektiv mbikëqyrës që mbikëqyr zhvillimin dhe funksionimin e praktikës së falimentimit, duke përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të falimentimit dhe veprimtarinë e Administratorëve të Falimentimit, duke përfshirë edhe nevojën për rishikim të kriterëve të licencimit dhe rilicencimit.

Sa i përket Administratorëve të Falimentimit është shumë e rëndësishme të konsolidohet korniza ligjore sa i përket licencimit të tyre, mirëmbajtjes së listës së Administratorëve të certifikuar, raportimit dhe mbikëqyrjes, situatat e konfliktit të interesit dhe të ngjashme. Edhe pse Administratorët e Falimentimit kanë specifikat e veta si profesion meqë të njëjti e kryejnë punën e tyre nën mbikëqyrjen e Gjykatës me rastin e caktimit të tyre si Administrator Falimentues, megjithatë është e rëndësishme që të rregullohet mekanizmi i mbikëqyrjes administrative, i cili mund të përfshijë edhe rrethanat e humbes së licencës dhe mekanizmi i llogaridhënies, duke përfshirë mundësitë që Gjykatat të drejtohen Ministrisë së Drejtësisë me njoftime lidhur me performancën dhe shkeljet eventuale të Administratorit të Falimentimit. Po ashtu ndryshimet e kornizës ligjore ekzistuese duhet të përfshijnë edhe dispozitat lidhur me përfshirjen e shtetasve të huaj në regjistrin e administratoreve falimentues.

Korniza ligjore ekzistuese duhet po ashtu të adresojë organizimin e Administratorëve të Falimentimit përmes Odës së administratorëve falimentues dhe edukimin dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve përkatëse.

Shkaku 1.2.4. Mungesa e kornizës ligjore që rregullon procedurën e falimentimit për Ndërmarrjet Publike: Aktualisht në Kosovë ndërmarrjet publike nuk kanë kornizë ligjore që rregullon falimentimin e tyre, në rast të nevojës për të hyrë në procedura të falimentimit kjo është e pamundur për shkak se aktualisht nuk ka ligj apo akt nenligjor që e rregullon procedurën e falimentimit të ndërmarrjeve publike. Kjo është sa sfiduese edhe problematike sepse pamundëson zhvillimin e procedurave të falimentimit për ndërmarrjet publike.

Shkaku 1.2.5 Mundësitë e kufizuara për zhvillimin profesional për profesionistët ligjor dhe shtrirjen e kufizuar: Ka trajnime të rregullta për Ligjin e ri për Falimentim të organizuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës, por ka interes shumë të kufizuar të

avokatëve për të hyrë në praktikën e falimentimit. Oda e Administratorëve të Falimentimit është shumë e re, dhe ka burime të kufizuara për të ndihmuar në mbështetjen e kapaciteteve të profesionit ose promovimin e profesionit tek avokatët dhe në përgjithësi te profesionistët ligjor. Ky është një hendek shumë serioz për të parë avancimin e praktikës së falimentimit. Gjithashtu, shtrirja tek pjesëmarrësit kryesorë të procesit ka qenë e kufizuar. Duhet konsideruar mundësia që avokatët që përfaqësojnë palët në procedurat e falimentimit të kalojnë një procedurë certifikimi, kjo do të mundësonte rritjen e interesimit të avokatëve për fushën e falimentimit dhe ngritjen e profesionalizmit të tyre.

Shkaku 1.2.6 Stigma kulturore: Ashtu si në shumë vende të tjera, Falimentimi ka një konotacion negativ në Kosovë. Falimentimi paraqet fundin e një veprimtarie Shoqëri Tregtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në besueshmërinë profesionale të një personi që qëndron pas një Shoqërie Tregtare. Mungesa e fushatave vetëdijesimi e ka bërë të vështirë të shpjegohen përfitimet e aplikimeve për falimentim, të kuptuarit e likuidimit nga një borxh dhe perspektivën e lehtësimit individual, dhe se procedurat e falimentimit gjithashtu mund të shpëtojnë bizneset përmes riorganizimit.

Shkaku 1.2.7. Sfidat me `shuarjen administrative`: Procesi i shuarjes administrative të shoqërive tregtare rregullohet me dispozitat e Ligjit për Shoqëri Tregtare, kjo rrezikon sigurinë e kreditorëve nëse shuarja e tillë nuk bëhet duke u harmonizuar edhe me Ligjin për Falimentimin, duke iu mundësuar shoqërive tregtare të shuhen pa kaluar nëpër procedurat e falimentimit.

Kapitulli 1.3 Efektet

Efekti 1.3.1 Besim i ulët në procedurat e falimentimit: fillimi i procedurës së falimentimit nuk inkurajohet për shkak të pragut kërkues i cili kërkon së paku dy kreditorë të iniciojnë një rast të pavullnetshëm të falimentimit në të njëjtën kohë.

Efekti 1.3.2 Maksimizimi i kthimeve të përgjithshme tek kreditorët është vënë në rrezik: Mungesa e kriterëve kur procedurat e ofrimit publik për shitjen e pasurive nuk ndiqen në një procedurë të likuidimit i jep kompetencë të padrejtë, diskrecionuese Administratorëve të Falimentimit. Anashkalimi i procedurave të ofertës publike pa kriterë të qarta për t'u ndjekur në kthim mund të rrezikojë maksimizimin e kthimit të përgjithshëm tek kreditorët.

Efekti 1.3.3 Përdorimi i kufizuar i mjeteve të ristrukturimit nga bizneset: Për shkak të mungesës së njohurive mbi përfitimet që rrjedhin nga ligji i ri, bizneset nuk e përdorin atë

si një mjet për të ristrukturuar kompanitë e vlefshme për t'i mbajtur ato gjallë kur përballen me vështirësi financiare.

Efekti 1.3.4 Qasjet negative drejt procedurave të falimentimit: asnjë biznes nuk e konsideron falimentimin si një mjet për të ruajtur aktivitetet e tij, as avokatët nuk ua propozojnë ato klientëve të tyre si mjete të zbatueshme.

Efekti 1.3.5 Mungesa e mbikëqyrjes së implementimit: nuk ka asnjë organ të caktuar për të monitoruar praktikën e falimentimit, i cili korrespondon me mungesën e mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit dhe mungesën e mbikëqyrjes së përgjegjshmërisë për Administratorët e Falimentimit.

Efekti 1.3.6. Mungesa e rregullimit ligjor për falimentimin e ndërmarrjeve publike: nuk ka ligj apo akt nënligjor që rregullojnë falimentimin e ndërmarrjeve publike.

Efekti 1.3.7. Pasiguria e kreditorëve për shkak të dispozitave ekzistuese të shuarjes administrative, që u mundëson bizneseve shuarjen pa iu nënshtruar procedurave të falimentimit.

Tabela 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji për Falimentim (Ligji nr. 05/L-083)	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12664	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Ministria e Drejtësisë;	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e regjimit të falimentimit; Mbajtja e regjistrit për administratorët e falimentimit dhe mbajtja e provimit dhe licencimi i administratorëve të falimentimit; Zbatimi i legjislacionit

		Gjykatat	
Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 06/L-016)	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Gjykatat	Hartimi dhe implementimi i legjislacionit; Zbatimi legjislativ: llojet e bizneseve që kanë të drejtë për regjimin e falimentimit siç rregullohet me Ligjin për Falimentim (Ligji nr. 05/L-083)
Ligji për Gjykatat (Ligji nr. 05/L-54)	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302	Ministria e Drejtësisë; Gjykatat	Hartimi i legjislacionit; Zbatimi legjislativ; Juridiksioni substancial dhe territorial i rasteve të falimentimit
Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006)	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2583	Ministria e Drejtësisë; Gjykatat	Hartimi i legjislacionit; Zbatimi i Ligjit për çështje që nuk trajtohen në Ligjin për Falimentim në lidhje me shërbimin e njoftimeve dhe çështjeve të ngjashme
Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2579	Ministria e Drejtësisë; Gjykatat	Hartimi i legjislacionit; Zbatimi i Ligjit për çështje që nuk trajtohen në Ligjin për Falimentim në lidhje me shërbimin e

(Ligji nr. 04/L-118)			njoftimeve dhe çështjeve të ngjashme
Ligji për Procedurën Përmbaremore (Ligji nr. 04/L-139)	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870	Ministria e Drejtësisë; Gjykatat Agjentët Privat të Përmbaremit	Hartimi i legjislacionit; Vendimi për propozimin e përmbaremit; Zbatimi i vendimit gjyqësor; Vendimi për ekzekutimin e borxhit
Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (Ligji nr. 05/L-118)	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14673	Ministria e Drejtësisë; Gjykatat Agjentët Privatë të Përmbaremit	Hartimi i legjislacionit; Vendimi për propozimin e përmbaremit; Zbatimi i vendimit gjyqësor; Vendimi për ekzekutimin e borxhit
Kodi Penal (Kodi nr. 06/L-074)	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413	Ministria e Drejtësisë; Prokuroria	Hartimi i legjislacionit; Sigurimi i veprave penale në fushën e falimentimit
LIGJI NR. 08/L-015 PËR GJYKATËN KOMERCIALE	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748	Ministria e Drejtësisë Gjykata Komerciale	Hartimi i legjislacionit; Zbatimi legjislativ; Juridiksioni substancial dhe territorial i rasteve të falimentimit,

Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i ndryshuar)	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547	Ministria e Ekonomisë	Hartimi i legjislacionit; Zbatimi legjislativ;
--	---	-----------------------	---

Tabela 3: Esenca e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Besimi i ulët në procedurat e falimentimit
	Maksimizimi i kthimeve të përgjithshme tek kreditorët është vënë në rrezik
	Mungesa e vetëdijesimit në mesin e bizneseve
	Qasjet negative në drejtim të procedurave të falimentimit
	Mungesa e mbikëqyrjes së implementimit dhe rregullimit për administratorët falimentues
	Mungesa e kornizës ligjore për falimentimin e ndërmarrjeve publike
Problemi kryesor	Një numër jashtëzakonisht i vogël i aplikimeve për falimentim në gjykata. Që nga miratimi i ligjit në vitin 2016, janë paraqitur vetëm katër raste. Bizneset e konsiderojnë ligjin si kompleks për të korrur përfitimet e tij, bizneset nuk janë të informuara për ekzistencën e ligjit të ri, ose bizneset nuk janë të vetëdijshme për përfitimet e aplikimit për falimentim.
Shkaqet	Kërkesat ligjore për inicimin e rasteve
	Mungesa e kriterëve për siguruar maksimizimin e kthimeve të kreditorëve
	Mungesa e një Autoriteti Mbikëqyrës për administratorët falimentues
	Mungesa e kornizës ligjore për falimentimin e ndërmarrjeve publike
	Mundësitë e kufizuara të zhvillimit profesional për profesionistët ligjor
	Shtrirja e kufizuar tek palët e interesit sa i përket Ligjit për Falimentim
	Stigma kulturore

Tabela 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efkti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1.2.1; 1.2.2; 1.2.3; 1.2.5; 1.2.7; 1.2.8	1.3.1; 1.3.2; 1.3.3; 1.3.4; 1.3.5	Sponsor i ligjit
Ministria e Drejtësisë	1.2.4; 1.2.3; 1.2.5; 1.2.6; 1.2.7; 1.2.8	1.3.3; 1.3.4; 1.3.5	Implementues i pjesshëm i ligjit (Administratorët e Falimentimit)
Departamenti Ekonomik i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit	1.2.4; 1.2.8	1.3.1; 1.3.4	Implementues i ligjit
Odat Ekonomike	1.2.2; 1.2.8	1.3.1; 1.3.2; 1.3.3; 1.3.4	Përfaqësojnë përdoruesit primar të ligjit
Bankat Komerciale	1.2.1; 1.2.2; 1.2.5; 1.2.8	1.3.1; 1.3.2; 1.3.3; 1.3.4	Përdorues të ligjit
NMV-të	1.2.1; 1.2.2; 1.2.5; 1.2.8	1.3.1; 1.3.2; 1.3.3; 1.3.4	Përdorues të ligjit
Ministria e Ekonomisë	1.3.6.		Përdorues të ligjit

Kapitulli 2: Objektivat

Tabela 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit
Rritja e aplikimeve të falimentimit përmes ndryshimeve të duhura në Ligjin e Falimentimit	Objektivi është hartuar në përputhje me gjetjet e këtij Koncept Dokumenti.
Objektivi Strategjik - Rritja e efektivitetit të falimentimeve tregtare dhe regjimeve të rikuperimit të borxhit	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Blloku 2: Kriteret Ekonomike
Objektivat specifike: 1. Përshtatja e Ligjit për Falimentim me kontekstin lokal; 2. Inkurajimi i riorganizimit të ndërmarrjeve në kohë të vështirësive financiare; 3. Promovimi i pjesëmarrjes së kreditorit dhe inkurajimi i fillimit të procedurës; 4. Maksimizimi i kthimit të përgjithshëm tek kreditorët; 5. Inkurajimi i veprimtarisë sipërmarrëse; 6. Vendosja e bazës ligjore për një autoritet mbikëqyrës 7. Vendosja e bazës ligjore për falimentimin e ndërmarrjeve publike	Objektivat janë rezultat i analizës së prodhuar për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti.

Kapitulli 3: Opsionet

Për të adresuar problemin kryesor të identifikuar dhe analizuar në këtë Koncept Dokument, tre mundësi janë paraqitur më poshtë: "pa ndryshim", sipas të cilit situata aktuale dhe rrjedhimisht vështirësitë e paraqitura në praktikë do të vazhdojnë (Opsioni 1).

Analiza e bërë për këtë Koncept Dokument tregon se për të përmirësuar regjimin e falimentimit të Kosovës, përmirësimi i zbatimit të disa aspekteve të Ligjit ekzistues të Falimentimit është i nevojshëm (Opsioni 2).

Përmirësimi i zbatimit do të kërkojë trajnim të zgjeruar të profesionistëve juridikë në ligjin e falimentimit, dhe ndërgegjësim të rritur të komunitetit të biznesit për përfitimet që vijnë nga aplikimet për falimentim. Sidoqoftë, trajnimet dhe fushatat vetëdijësuese nuk do të adresojnë mangësitë ligjore që janë identifikuar në ligjin aktual.

Ndryshimet e propozuara duhet të kontribuojnë në një rritje të rasteve t'u paraqitura në Gjykatë për falimentim. Me ndryshimet në Ligjin për Falimentim në fuqi (Opsioni 3), efektiviteti i trajnimeve dhe fushatave vetëdijësuese gjithashtu mund të përmirësohen dukshëm.

Si rezultat, ndryshimi i Ligjit për Falimentim (Opsioni 3) duket se është opsioni më i favorshëm i politikës, siç ilustron në Kapitullin 3.3, për të adresuar problemin kryesor të identifikuar në këtë Koncept Dokument: një numër jashtëzakonisht i vogël i rasteve të falimentimit në gjykata.

Zgjidhja e opsionit 3 duket se është zgjidhja më e mirë meqë opsionet 1 dhe 2 nuk do të mund të ofrojnë adresimin efektiv të problemeve me të cilat ballafaqohet procesi i falimentimit në Kosovë.

Kapitulli 3.1: Opsioni "pa ndryshim"

Sistemi juridik i Republikës së Kosovës e ka të mbuluar edhe fushën e falimentimit si njëra ndër fushat me një rendësi vitale në funksion të zhvillimit dhe avancimit të Shoqërive Tregtare e të cilat kanë funksionin kryesor në zhvillimin ekonomik në vend. Reformën e fundit në këtë fushë e kemi në vitin 2016 e cila për qëllim kishte evitimin e pengesave në praktik dhe avancimin e kësaj fushe edhe konform standardeve ndërkombëtare, që më pas të kenë refleksion pozitiv në Shoqërit Tregtare. Nëse i referohemi aspektit kohor, kjo reformë është realizuar që 6 vite dhe si e tillë nuk ka gjeneruar të dhëna që mund të

kualifikohen të suksesshme në fushën e falimentimit. Zgjedhja e opsionit "Pa ndryshim" është njëri ndër opsionet e mundshme, mirëpo ky opsion i referohet vetëm asaj çka është reformuar deri në vitin 2016 e para, ndërsa nga viti 2016 dhe gjer me ditët e sotme kemi shumë ndryshime shoqërore, ekonomike, tregtare, juridike etj. Andaj ky opsion nuk do ta ketë të mundur që të ketë brenda vetes të inkuorporuara nevojën për reformim konform ndryshimeve shoqërore që kanë ndodhur që 6 vite. Ky opsion do ta mundëson që të kemi një gjendje të njëjtë si në aspektin e reformimit të legjislacionit po ashtu edhe sa i përket edhe efektit nga zbatimi dhe sa janë të nevojshme këto për ditët e sotme, nuk mund të jemi të sigurt. Ky opsion do të ishte një opsion i dobishëm nëse nga praktika do të kemi të dhëna pozitive e të cilat janë në relacion edhe me gjendjen faktike. Përmes këtij opsioni do të ngadalësohet përparimi i Kosovës në ndërtimin e një falimentimi efektiv tregtar dhe një regjim të rikuperimit të borxhit, i cili ndikon në klimën e investimeve dhe rritjen ekonomike. Qëndrimet dhe vlerësimet negative të bizneseve ndaj praktikës së falimentimit do të vazhdojnë të zbehin efektivitetin e Ligjit për Falimentim në ndihmën e bizneseve që të gjejnë lehtësim të borxhit përmes likuidimit ose të shpëtojnë aktivitetin e tyre të shoqërisë tregtare përmes riorganizimit.

Përmes këtij opsioni do të jetë e mjaftueshme që të kualifikohet se në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës është e mbuluar edhe fusha e falimentimit. Mirëpo kjo nuk mjafton, për faktin se qëllimi i një politike dhe legjislacioni është efekti juridik në aspektin praktik e që në rastin e Kosovës nuk është edhe shumë në nivel të duhur dhe të kërkuar. Andaj konform kësaj gjendje sipas këtij opsioni i cili e promovon status kohen, nuk ka të ngjarë që bizneset në vështirësi financiare të fillojnë të përdorin procedurat e falimentimit pa e ndryshuar ligjin për të futur dispozita për stimulimin e bizneseve për të përdorur riorganizimin ose likuidimin. Sigurisht që kjo do të vijë në shprehje duke e zvogëluar stigmën kulturore karshi falimentimit dhe për të zgjatur potencialisht procedurat e përshpejtuara të riorganizimit, të prezantuara fillimisht për NVM, gjithashtu për sipërmarrësit. Për më tepër, është edhe një faktor tjetër që ka refleksion në këtë situatë dhe nuk do të ndryshojë nëse kuadrat e rinj të avokatëve dhe profesionistëve juridikë nuk specializohen në ligjin e falimentimit dhe, më pas, avokojnë për përdorimin e procedurave të falimentimit.

Nëse i referohemi gjendjes faktike sa i përket fushës së falimentimit dhe efikasitetit në praktik, ky opsion mundëson që në aspektin e infrastruktures ligjore për fushën e falimentimit të jemi në rregull, mirëpo sa i përket efikasitetit dhe sukseseve në këtë fushë për Shoqëri Tregtare, ky opsion është i mangët dhe nuk e mundëson këtë. Nëse e marrim për bazë edhe një fakt tjetër që është shumë më rëndësi për këtë opsion, i referohet statusit të shtetit të Kosovës dhe sistemit të ti juridik e të cilët në çdo aspekt janë të ri dhe është në pamundësi që ky opsion të jetë i duhuri, pasi duke qenë i ri dhe në vazhdimësi në tendenc

për kompletim, reformim dhe avancim, status koha nuk është opsioni real për kohën dhe aspiratat e shtetit dhe sistemit juridik të Kosovës. Andaj ky opsion është në disarmoni me gjendjen faktike në fushën e falimentimit si dhe me nevojën për ndryshime të nevojshme e të cilat mundësojnë zhvillim dhe avancim të kësaj fushe.

Kapitulli 3.2: Përmirësimi i implementimit të kornizës aktuale ligjore (Opsioni 2)

Për sistemin juridik sfida e parë është që një fushë e caktuar e saj të mbulohet me legjislacion përkatës i cili në aspektin e dispozitave përkatëse ligjore të rregulloj një fushë të caktuar. Edhe fusha e falimentimit është e mbuluar me legjislacion përkatës në fuqi për më shumë edhe e reformuar dhe avancuar konform ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe juridike. Obligimi i sistemit juridik nuk përfundon vetëm me kompletimin e infrastrukturës ligjore, në shtetet në tranzicion dhe ato me traditë jo edhe të gjatë juridike, sfida është në zbatim të legjislacionit dhe kjo pamundëson që të jenë të dukshme efektet juridike. Befasuese për fushën e falimentimit është fakti se nuk janë vërejtur pengesa në zbatim e për të cilat ka nevojë që të ndërhyhet por pa pasur nevojë që të ndryshohet infrastruktura ligjore. Problemi në fushën e falimentimit nuk është tek zbatimi apo tek ndonjë çështje tjetër që varet nga vullneti i faktorit njëri, mirëpo është më i thellë dhe i tejkalon këtë lloj të pengesave e të cilat janë të karakterit të rregullimit të saktë dhe të duhur të dispozitave përkatëse ligjore. Opsioni i dytë shqyrton mundësitë për adresimin e numrit të ulët të rasteve të inicuar për falimentim pa ndryshuar ligjin ekzistues. Ky opsion konsideron mundësinë e përmirësimit të zbatimit të kornizës ligjore aktuale përmes udhëzimeve shtesë administrative për të siguruar zbatimin koherent të ligjit, pajtueshmërinë e gjykatës me ligjin, trajnimin e vazhdueshëm të profesionistëve juridikë, fushatat e rritjes së vetëdijes që synojnë komunitetin e biznesit dhe sipas këtij opsioni fokusi duhet të jete tek mekanizmat tjerë që mundësojnë zbatimin e legjislacionit ekzistues, por pa pasur nevojë që të plotësohen apo ndryshohen dispozitat përkatëse ligjore

Ministritë e linjës lëshojnë udhëzime administrative vetëm për fushat e ligjit që ligji thotë qartë se ato do të rregulloheshin përmes një akti nënligjor. Ligji për Falimentimin parashikon vetëm nxjerrjen e akteve nënligjore për kualifikimin, trajnimin ose licencimin e Administratorëve të Falimentimit. Qeveria nxori dy akte nënligjore – UA 01/13 për Programin e Provimit për Administratorët e Falimentimit dhe Rregulloren 22/2012 për Përcaktimin e Kualifikimeve Speciale, Shpërblimet dhe Kompensimin dhe Procedurën e Licencimit të Administratorëve të Falimentimit – që nuk janë objekt i problemeve të identifikuar në këtë Koncept Dokument. Sistemi jon juridik nuk mundëson që të nxjerren akte nënligjore përmes së cilave mundësohet zbatimi më i mirë i legjislacionit primar. Kjo

formë nuk është e lejuar fillimisht dhe si e tillë nuk mund të jetë as si opsion i duhur, për faktin se, akti nënligjor duhet që të jetë i përcaktuar në Ligj që me pas i njëjti të nxjerret. Edhe mekanizmat tjerë siç janë trajnimi i profesionistëve ligjor, fushatat sensibilizuese për Shoqëritë Tregtare, nuk është që nuk janë zbatuar, mirëpo nuk kanë derivuar efekt juridik të duhur në fushën e falimentimit përkatësisht në zhvillimin, avancimin, ruajtjen e Shoqërive Tregtare dhe ofrimin e shancit të dytë.

Kapitulli i Parimeve të Përgjithshme të Ligjit për Falimentim (neni 4) thotë qartë se procedurat e falimentimit konsiderohen urgjente. Sidoqoftë, Gjykata nuk ka të dhëna për përparimin e çështjeve të tilla. Duhet mesatarisht mbi dy vite që një procedurë falimentimi të përfundojë. Fillimi i një Falimentimi dhe hapja e rastit normalisht duhet të ndodhë brenda një jave, pasi ekziston rreziku i transferimit të paligjshëm të pasurive që ndodh shpesh. Këto afate nuk respektohen dhe ka vonesa të konsiderueshme në shpërndarjen e njoftimeve nga Gjykatat tek Palët, duke krijuar kështu mos besim midis Palëve dhe duke kontribuar në një numër të vogël të rasteve. Veprimet gjyqësore dhe pajtueshmëria e gjyqtarëve me ligjin duhet të adresohen nga KGJK-ja. Sidoqoftë, për shkak se praktika e falimentimit të Kosovës është e re dhe vetë Ligji për Falimentim ka qenë në fuqi vetëm për më pak se katër vite, pas një vakumi ligjor mbi 17 vite, gjykatësit nuk kanë vetëbesim në trajtimin e çështjeve të falimentimit.

Avokatëve dhe bizneseve gjithashtu u mungon përvoja dhe ndërgjegjësimi për përfitimet e procedurave të falimentimit. Ndërsa ligji ekzistues është në përputhje me standardet ndërkombëtare, përmbajtja e tij nuk është rregulluar për t'iu përshtatur kontekstit lokal. Bizneset mbajnë një qasje negative ndaj procedurave të falimentimit, ndërsa avokatët nuk kanë përvojë në përdorimin e likuidimit si një mjet për lehtësimin e bizneseve Shoqërisë Tregtare dhe riorganizimin si një mjet për shpëtimin e një veprimtarie të Shoqërisë Tregtare.

Pavarësisht nëse janë të nevojshme ndryshimet për të përmirësuar zbatimin e ligjit aktual (Opsioni 3), Ministria e Drejtësisë duhet të organizojë vazhdimisht trajnime dhe aktivitete në terren që targetojnë profesionistët juridikë, veçanërisht avokatët, dhe odat ekonomike, të cilat përfaqësojnë interesat e Shoqërisë Tregtare. Oda e Avokatëve të Kosovës gjithashtu duhet të vazhdojë të sigurojë trajnime mbi Ligjin e Falimentimit, megjithë interesin e kufizuar të avokatëve, dhe të konsiderojë targetimin e avokatëve të rinj për t'i inkurajuar ata të specializohen në Ligjin e Falimentimit. Paralelisht, Ministria e Drejtësisë duhet të mbështesë Odën e Administratorëve të Falimentimit në forcimin e kapaciteteve të tyre për të promovuar praktikën e falimentimit.

Megjithatë, efekti i trajnimeve dhe fushatave vetëdijësuese është vetëm marginal pa ndryshime ligjore në ligjin ekzistues. Nëse bëhen ndryshime në ligj (Opsioni 3), trajnimet dhe fushatat vetëdijësuese do të jenë akoma të nevojshme. Sidoqoftë, efekti i tyre do të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme me ndryshimet në fuqi të Ligjit për Falimentimin.

Nga te dhënat që posedohen për fushën e falimentimit dhe efektin në praktik të legjislacionit përkatës në fuqi, nuk rezulton se problemi është në ndonjë pjesë që i referohet zbatimit të legjislacionit dhe nevojën për ndërhyrje që të ketë zbatim të duhur. Që të jetë e suksesshme fusha e falimentimit dhe të arrin efikasitetin juridik, nuk është problemi që duhet të ketë aktivitete tjera e të cilat mund të kenë ndikim në rritjen e numrit të lëndëve në procedurën e falimentimit, riorganizimit dhe likuidimit. Ky opsion do të ishte një vazhdim i gjendjes aktuale dhe sigurisht që nuk do të mundësonte një reform konform të gjeturave dhe kërkesave.

Kapitulli 3.3: Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit për Falimentim (Opsioni 3)

Sistemi juridik i Republikës së Kosovës, nga viti 2007 në kuadër të vetë, ka nxjerr legjislacionin përkatës në fuqi me të cilin ka rregulluar fushën e likuidimit dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim. Mirëpo duke pasur për bazë çdo herë ndryshimet shoqërore dhe nevojën e harmonizimit të tyre me dispozita përkatëse ligjore, reformimin e fushës së falimentimit e kemi që në vitin 2008, duke e plotësuar dhe ndryshuar legjislacionin e falimentimit. Edhe reforma e vitit 2008 nuk ishte shumë e dobishme dhe nuk arriti që të ketë efekt juridik dhe lindi nevoja për një reformë të përgjithshme e cila ndodhi në vitin 2016 me nxjerrjen e Ligjit për Falimentim. Përmes këtij ligji u synua që të ketë një reformë të thellë në fushën e falimentimit dhe përmes saj të inkorporohen edhe standardet ndërkombëtare e të cilat do të kenë efekt pozitiv në avancimin dhe zhvillimin e falimentimit në Kosovë.

Duke ju referuar numrit të madhe të Shoqërive Tregtare në Kosovë dhe faktit se jo të gjitha në aktivitetin e tyre janë të suksesshme dhe rrjedhimisht ka lindur nevoja për riorganizim, likuidim dhe falimentim, mirëpo në praktik nuk kemi numër të Shoqërive Tregtare që janë në procedurën e falimentimit, apo mund të themi së është numër shumë i vogël dhe në kundërshtim me gjendjen faktike. Numri shumë i vogël i Shoqërive Tregtare që janë proceduar në procedurën e falimentimit a ne fakt ky numër është shumë më i madh që e ka të nevojshme këtë procedurë, është indikacion që diçka nuk është duke funksionuar dhe është bazë që legjislacionin duhet që të vlerësohet dhe rishikohet me qëllim të eliminimit të problemeve përkatëse me qëllim që procedura e falimentimit të jetë e suksesshme dhe numri i Shoqëri Tregtare të jetë më i madh që fillojnë këtë procedurë. Problemet në praktik

të identifikuara e të cilat janë me refleksion në cilësinë e procedurës së falimentimit e krijojnë arsyen që të kemi një ndryshim dhe plotësim të legjislacionit përkatës në fuqi. Për shkak të kufizimeve të legjislacionit para Ligjit për Falimentimin 2016, praktika e falimentimit të Kosovës ka qenë duke zënë fill. Vakumi juridik 17 vjeçar pas konfliktit, pasi bizneset kosovare ishin krijuar dhe zhvilluar tashmë dhe nuk kishte praktikë falimentimi, siguron kontekstin për të shpjeguar vështirësitë për bizneset dhe profesionistët ligjorë për të zbatuar Ligjin për Falimentim.

Janë identifikuar fusha specifike të ligjit që nuk ndjekin drejtpërdrejt parimet e renditura në nenin 4.1 të ligjit. Për të rritur numrin e rasteve të inicuar të falimentimit, Opsioni 3 propozon ndryshimin e ligjit për:

- (a) të inkurajuar riorganizimin në kohë të vështirësive financiare;
- (b) të promovuar pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të kreditorit;
- (c) zvogëluar stigmën kulturore drejt falimentimit;
- (d) prezantuar dispozitat e "shansit të dytë" për ndërmarrjet e dështuara, por të ndershëm; dhe
- (e) për të krijuar një autoritet mbikëqyrës i cili dotë ndikonte në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies.
- (f) evituar pengesat ekzistuese që po ndikojnë negativisht në mundësinë për të incuar rastet e falimentimit;

(a) Stimulimi i riorganizimit si një mjet për të rivendosur Shoqërinë Tregtare te debitorit, për të ruajtur vendet e punës dhe për të vazhduar operacionet e Shoqërisë Tregtare

Rregullimi i fushës së falimentimit është një fushë që është shumë gjithëpërfshirëse dhe atakon shumë fusha tjera që janë me refleksion në zhvillim ekonomik, siguri juridike, rritje të punësimit dhe realizim të borgjeve tek kreditori. Me qellim të rregullimit sa më të mirë të fushës së falimentimit që e njëjta të jetë edhe në funksion të fushave tjera, duhet që të ketë rregullim në mënyrë graduale përmes konceptit të shkallshmërisë sa i përket masave të ndërmarra dhe efekteve të tyre. Sigurisht që shkalla e parë dhe ajo me një rëndësi të veçantë është riorganizimi i ndërmarrjeve, i cili ka në funksion parandalimin e falimentimit dhe njëherit reflektimi përball atyre pjesëve që kanë shkaktuar probleme të caktuara.

Sigurisht që pjesa e riorganizimit në politiken e re përkatësisht në plotësim ndryshimin e legjislacionit duhet që të reflekton problemet që janë shfaqur në praktik dhe avancimin e këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm para falimentimit.

Riorganizimi duhet që të jetë i rregulluar në atë masë, sa që në shumicën e rasteve duhet të përcaktohet dhe të gjeneron efekt juridik për ndërmarrjet pa pasur nevojë që e njëjta të

procedohet për në falimentim. Sigurisht që riorganizimi është në funksion të shumë fushave tjera dhe aq më shumë në fushën e ruajtjes së vendeve të punës e cila parandalon rritjen e numrit të të pa punëve e të cilët më pas bëhen barrë e shtetit, më pas refleksioni është edhe tek zhvillimi ekonomik, pasi një ndërmarrje më shumë është me refleksion pozitiv në zhvillimin ekonomik, më pas refleksioni është edhe tek avancimi i teknologjisë dhe shkëmbimi i kapitalit dhe përvojave e të cilat hyn në funksion të zhvillimit dhe avancimit të vendit.

Riorganizimin duhet te vlerësojmë si masë fillestare e cila duhet që të ketë më pak kritere për këtë opsion, por më shumë e praktikuar, pasi kjo mundëson që të intervenohet që në fazën fillestare kur një ndërmarrje ka shfaq probleme e të cilat nëse vazhdohet mund të krijojnë situatën e që ndërmarrja te shkon drejt falimentimit. Andaj intervenimi që në fazën fillestare përmes riorganizimit, mundëson që përmes disa masave të ndërmarrja një ndërmarrje të jetë aktive dhe mos të vërej krizën e cila është bazë për fillim të procedurës së falimentimit nga ana e kreditorëve apo vetë debitorit. Duke ju referuar që në këtë pjesë është duke u arsyetuar opsioni 3 e i cili është plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit ekzistues për fushën e falimentimit, duhet që ndryshimet të jenë konkrete dhe në funksion të fuqizimit sa më të madh të riorganizimit.

Njeri ndër arsyetimet pse legjislacioni duhet te ndryshohet është pjesa e riorganizimit e cila duhet që të përcaktohet përmes kushteve që duhet të plotësohen, mirëpo kushtet duhet që të jenë shumë më të lehta, mirëpo përmes së cilave arrihet që të ketë vlerësim real të gjendjes së Shoqërisë Tregtare. Mundësia që përmes këtyre kushteve të realizohet sakt gjendja reale të Shoqërisë Tregtare, do të jetë në funksion të ruajtjes së vlerave të Shoqërisë Tregtare por edhe eliminimin e atyre pjesëve që janë për momentin jo edhe të suksesshme për Shoqërinë Tregtare.

Aktualisht, kriteret për të dorëzuar një kërkesë për fillimin e rastit kundër një debitori të ligjshëm kërkohet që të plotësohen disa kushte e të cilat krijojnë vështirësi tek debitorët që kanë interesim që të parashtrij një kërkesë të tillë. Rastet e falimentimit të pavullnetshëm mund të fillojnë nga të paktën dy kreditorë kur ai debitor nuk ka arritur të paguajë një borxh për secilin prej kreditorëve të peticionit, dhe secili borxh ka qenë i detyrueshëm dhe i pagueshëm për të paktën nëntëdhjetë (90) ditë; shuma totale e borxhit të detyruar është të paktën tre mijë (3,000) Euro në shumë; dhe secili borxh nuk është i kushtëzuar ose nuk i nënshtrohet procedurës gjyqësore në pritje ose një arbitrazhi në vazhdim. Përveç kësaj, kreditorët duhet të dëshmojnë gjithashtu se debitori në përgjithësi nuk i paguan borxhet e veta pasi ato bëhen të detyrueshme, dhe totali i borxheve të papaguara tejkalon pesë mijë (5000) Euro. Fusha e aplikimit duhet të pasqyrojë realitetin e Kosovës në drejtim të debitorëve të kualifikuar për këtë proces.

Ky kufizim është i dëmshëm për debitorët, kjo për faktin se jo çdo herë mund të kemi bashkëpunim mes kreditorëve dhe bashkërendim të aktiviteteve për të parashtruar një kërkesë. Kufizimi në dy kreditor, dëmton kreditorin i cili ka interesim që të fillon procedurën e falimentimit nga e cila varet siguria e kapitalit e i cili gjendet te debitori. Kufizimi se duhet të jenë të paktën dy kreditor e bart edhe rrezikun tjetër ku duhet që të jete e vlerësuar dhe ajo është bashkëpunimi i fshehtë mes kreditorit dhe një debitori që ky i fundit mos të bashkëpunoj me njërin nga kreditorët që ka shumë interes për fillim të procedurës së falimentimit dhe kjo ja pamundëson që të mbron dhe realizon borgjin nga debitori. Sigurisht që një kufizim është i arsyeshëm, mirëpo ky kufizim isha dashur që të jetë në vlerën e kërkesave mirëpo në një debitor pa pasur nevoj që të jenë një e më shumë. Sigurisht që ky kufizim është më i arsyeshëm dhe mundëson që rastet me kërkesa të mëdha e të cilat arsyetojnë fillimin e procedurës së falimentimit të kenë të drejtën që të fillojnë. Kriteri që është i përcaktuar në legjislacion shihet si shumë kërkuar, për shkak se në praktikë janë hasur probleme nga kreditorët që të mund të bëhen dy kreditorë për të inicuar rastin e falimentimit, për arsye të ndryshme. Ky rregullim është tejet jo i favorshëm për kreditorët që më të vërtet e kanë të nevojshme që të fillojnë procedurën e falimentimit.

Veprimi i propozuar: Duke pas për bazë se kufizimi se duhet që të jenë dy kreditor për të filluar procedurën e falimentimit është jo e arsyeshme. Andaj duhet që të ketë ndryshim në legjislacionin përkatës në fuqi për të rregulluar pragun e kreditorit për paraqitjen e një kërkesë të pavullnetshme të falimentimit, në mënyrë që të promovohet pjesëmarrja e kreditorit dhe të inkurajohet fillimi i procedurës. Do të jetë shumë më e arsyeshme që kufizimi të jetë në shumën e borxhit që pretendon kreditori se debitori i ka, se sa kufizimi të jetë në numrin e kreditorëve, pasi kjo e dëmton kreditorin. Kreditorët duhet të kenë mundësinë për të filluar individualisht një rast falimentimi të pavullnetshëm për borxhet më të vogla, ndërsa afati i nëntëdhjetë (90) ditëve duhet të ruhet si i arsyeshëm. Thjeshtësimi i kriterëve për paraqitjen e një kërkesë të pavullnetshme të falimentimit mund të rrisë ndjeshëm numrin e aplikimeve të falimentimit nga kreditorët, sepse do t'u evitohet pengesa ekzistuese e kushtit që së paku dy (2) kreditorë të mund të paraqesin një kërkesë për inicimin e rastit të falimentimit për debitorin. Gjithashtu, duhet të forcohet fushëveprimi i zbatimit të ligjit për bizneset e paregjistruara.

(b) Nxitja e likuidimit si një mjet për të maksimizuar kthimin e përgjithshëm të kreditorëve

Duke ju referuar, se likuidimi është masë më e ashpër për kapitalin e debitorit, sigurisht që kjo duhet që të përcaktohet qartë dhe saktë. Duke qen si masë më e ashpër , sigurisht që

edhe kushtet dhe kufizimet duhet që të jenë të përcaktuara saktë dhe të jene me standard më të lartë, por jo të tilla që vështirësojnë apo ndalojnë përmes kushteve të përcaktuar likuidimin kur ai është i arsyeshëm dhe i dobishëm konform gjendjes faktike. Te pjesa e likuidimit rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet përcaktimit të kushteve përkatëse e të cilat kur plotësohen nga ndërmarrja, janë bazë që ndërmarrja duhet të procedohet për në likuidim dhe atë qoftë nga kreditorët apo nga vetë debitori. Duke i përcaktuar qartë kushtet për likuidim, e përmes së cilave arrihet që të ketë vlerësim real te statusit të ndërmarrjes, kjo mundëson që vendimmarrja për procedim për likuidim të jetë objektive, reale, mbi gjendjen faktike dhe në dobi të ndërmarrjes, kreditorëve dhe debitorit si dhe interesit të përgjithshëm të vendit.

Pjesa e legjislacionit që kërkon të ketë reformim dhe avancim është ajo që i përket Administratorit Falimentues. Kjo pjesë duhet që të avancohet në drejtim që të përcaktohen qartë dhe saktë kompetencat e Administratorit Falimentues. Pozitën e Administratorit falimentues duhet te vlerësojmë shumë lartë, për faktin se është ai i cili posedon ekspertizën profesionale mbi te cilën mund të vendos saktë përmes propozimit që i bën Gjykatës që një ndërmarrje më të vërtet ka bazë për procedim për riorganizim apo likuidim. Andaj përcaktimi i qartë dhe zgjerimi i kompetencave dhe përgjegjësiive për Administratoret falimentues është në funksion të eliminimit të pengesave ligjore që ekzistojnë dhe avancimin e tyre e të cilat janë në funksion të avancimit të fushës së falimentimit.

Likuidimi mbi gjendjen reale dhe konform kushteve të përcaktuara është në lidhmeri direkte me Administratorin Falimentues, kjo për faktin se këto kanë një lidhmëri shumë të ngushtë mes vete sa i përket vlerësimit real të gjendjes së ndërmarrjes dhe arsyesimit për procedim për likuidim. Sa i përket likuidimit Administratorët e falimentimit janë përgjegjës për organizimin e shitjes së pasurive në procedurën e likuidimit. Administratori mund të organizojë një ankand publik, të angazhojë një shtëpi ankandi, ose të organizojë metoda të tjera të ofertave publike për shitjen e pasurive. Ligji i ri përcakton për administratorin që të paktën të përpiqet të rregullojë çmimin minimal në nivelin ose afër shumës së borxheve të organizatës në falimentim. Nëse çmimi minimal nuk mund të caktohet në nivelin e borxhit, Administratori i Falimentimit kërkon një leje nga Gjykata për të shitur asetet në çmimin më të lartë të ofruar në treg, dhe pa procedurat e ofertës publike.

Ndryshimet dhe avancimi i legjislacionit për falimentimit duhet që të përcaktojë kritere të rrepta që duhet të ndiqen nga Administratorët e Falimentimit kur nuk ndiqen procedurat e ofertës publike, duke siguruar që kthimet e përgjithshme për kreditorët të jenë maksimalizuar. Në mungesë të mbikëqyrjes së duhur për Administratorët e Falimentimit, mungesa e këtyre kritereve i jep kompetencë të padrejtë, diskrecionuese Administratorëve

të Falimentimit. Përpos këtyre, me rendësi që të përcaktohen janë edhe zgjerimi i kompetencave dhe përgjegjësi për administratoret falimentues në raport me vlerësimin, përcaktimin dhe rekomandimin për riorganizim dhe likuidim. Kushtet për riorganizim dhe likuidim duhet që të jenë të përcaktuar në atë formë, që Administratori Falimentues duhet vetëm ti vërtetoj dhe nga ky vërtetim të gjeneron raportin i cili varësisht prej gjendjes faktike duhet që të përcakton se një ndërmarrje i ka plotësuar kushtet për riorganizim apo likuidim. Kjo do e mundëson që të ketë profesionalizëm, objektivitet dhe përputhshmëri me gjendjen faktike të ndërmarrjes. Është me shumë interes për ndërmarrjen nëse më të vërtet gjendjen faktike e ka kompatible me kushtet për likuidim apo riorganizim që të procedohet tutje brenda afatit sa më të arsyeshëm kohorë, me qëllim që të parandalohet dëmtimi i mëtutjeshëm.

Pjesa tjetër që kërkon trajtim dhe avancim në kuadër të legjislacionit përkatës në fuqi, i referohet pjesë së shitjes së asetëve me rastin e likuidim. Me rendësi tek kjo pjesë është që mos të dëmtohet debitori në çmimin e shitjes së asetëve, ku çmimi duhet të jetë ai i tregut. Mirëpo nuk mund të ketë procedura të stërzgjatura të cilat dëmtojnë tej mase kreditorët, si rezultat i procedurave shumë të gjata sa i përket shitjes së asetëve. Përpos kësaj, ligji duhet të sqaroj dhe specifikoj procedurat për shitjen e pasurive në likuidim në mënyrë që të maksimizohen kthimet e përgjithshme tek kreditorët me qëllim që sa më shumë të realizon të drejtat tek debitori.

(c) Zvogëlimi i stigmës kulturore ndaj falimentimit

Ligji përcakton, në parimet e tij të përgjithshme, se debitorët e falimentuar do të shënohen në regjistrin e Shoqërisë Tregtare në çdo regjistrim të ri të një biznesi nga debitori dhe anëtarët e afërt të familjes për pesë (5) vite nga dita e përfundimit të procedurës së falimentimit; në mënyrë të ngjashme, do të shënohen në regjistrin e kredive. Identifikimi pesë-vjeçar në regjistrin e biznesit mund të jetë një faktor dekurajimi për Shoqërinë Tregtare të paraqesë falimentim, duke forcuar stigmën e bizneseve drejt falimentimit. Tek kjo pjesë duhet që të behet një dallim shumë i madh dhe ai ka të bëjë me atë që ndërlidhet me qëllimin e debitorit në raport me ndërmarrjen që ka pasur në raport me falimentimin. Sigurisht që nëse qëllimi i debitorit ka qenë që me qëllim të caktuar ta drejton ndërmarrjen në falimentim, sigurisht që periudha prej pesë (5) viteve është e arsyeshme apo mund të konsiderohet e arsyeshme edhe që të rritet kjo periudhë kohore. Mirëpo kemi raste që qëllimi i debitorit nuk ka qenë që ndërmarrja të falimenton, mirëpo për shkak të faktorëve tjerë ndërmarrja ka pësuar tronditje dhe keqsim të gjendjes financiare e cila ka shpije drejt falimentimit, sigurisht se për këto raste periudha prej pesë (5) vite është e lartë, andaj është me arsyetim që të ketë periudhë më të vogël pse mos të jetë në tri (3) vite pasi të mbzillet rasti.

Vlerësuesi i legjislacionit përkatës në fuqi për fushën e falimentimit në raport me reformimin dhe avancimit përmes plotësim ndryshimit, duhet të konsiderojnë uljen e periudhës kohore nga pesë (5) vite në tre (3) vite. Paralelisht, megjithatë, regjistri i Shoqëri Tregtare në të cilin regjistrohet falimentimi duhet të jetë në dispozicion të publikut për të parandaluar çdo partneritet të padëshiruar me bizneset e falimentuara. Transparenca e regjistrit të Shoqërisë Tregtare, sidoqoftë, është përtej fushëveprimit të këtij ligji.

Sa më shumë që të përcaktohen kushte të qarta për riorganizimin, likuidimin dhe çdo proces në procedurën e falimentimit, krijon besimin dhe sigurinë juridike si për kreditorët dhe debitorin. Duke përcaktuar kushtet dhe standardet përkatëse, falimentimi shihet si mundësi që është në dobi të ndërmarrjes e cila fillimisht si shancë e parë mund të riorganizohet, më pas nëse plotësohen kushtet procedohet për likuidim. Kjo qasje përmes kësaj forme të rregullimit eliminon në tërësi paragjykimin që debitorët mund të kenë për falimentimin në tërësi dhe kur plotësohen kushtet nuk ngurrojnë që të procedojnë tutje.

Veprimi i propozuar: Ndryshimi i parimeve të përgjithshme të ligjit duke marrë parasysh që procedurat e falimentimit tashmë shihen si negative nga komuniteti i biznesit.

(d) Paraqitja e Dispozitave "Shansi i Dytë" për Ndërmarrësit e Dështuar, por të ndershëm

Ky Koncept Dokument propozon prezantimin e dispozitave "shans të dytë" për sipërmarrësit e dështuar si një strategji e pashfrytëzuar për të inkurajuar aktivitetin sipërmarrës midis NVM-ve dhe bizneseve të mëdha. Procedurat e shpejtuara të falimentimit janë tashmë në dispozicion të NVM-ve. Sidoqoftë, aktualisht, sipërmarrësve të dështuar u mungon një mjedis pas falimentimit që mundëson rimëkëmbje të shpejtë. Për të zvogëluar barrën e falimentimit mbi sipërmarrjen, afati kohor që kufizon marrjen e një shkarkimi të dytë duhet potencialisht të zvogëlohet. Për më tepër, për të mbështetur kthimin e shpejtë të sipërmarrësve të dështuar në treg, Ligji duhet të rishikojë nevojën për të futur një flamur falimentimi në regjistrin e biznesit për sipërmarrësit e falimentuar për herë të parë, në mënyrë që ata të vazhdojnë të kenë shanse të barabarta si sipërmarrësit e tjerë. Duke futur dispozitat e "shansit të dytë" për sipërmarrësit e dështuar, Ligji për Falimentimin do t'i shërbente një mjedisi biznesi që është përfshirës i mentalitetit sipërmarrës për fillimin e ndërmarrjeve të reja, pa u dekurajuar për të marrë rreziqe.

Veprimi i propozuar: prezantimi i dispozitës që e kthejnë falimentimin në një përvojë mësimi për sipërmarrësit e ndershëm dhe mundësojnë rikthimin e tyre të shpejtë në treg. Kjo duhet të kuptohet së bashku me propozimin për të forcuar fushën e zbatimit të ligjit edhe për sipërmarrësit e paregjistruar.

(e) Fuqizimi i një autoriteti mbikëqyrës

Përtej fushëveprimit të ndryshimit të neneve ekzistuese, ligji duhet të prezantojë nene shtesë që përcaktojnë bazën ligjore për fuqizimin e *mbikëqyrjes administrative të praktikës së falimentimit dhe administratorëve të falimentimit*. Përveç kësaj, aktualisht nuk ka dispozita të qarta për të siguruar cilësinë dhe përgjegjshmërinë e administratorëve të falimentimit. Lista e administratorëve të falimentimit mirëmbahet nga Departamenti për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë me kompetenca administrative për të azhurnuar listën dhe administrimin e provimit të administratorit të falimentimit. Zhvillimi i praktikës së falimentimit varet nga një autoritet efektiv mbikëqyrës që mbikëqyr zhvillimin dhe funksionimin e praktikës së falimentimit, duke përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të falimentimit dhe veprimtarinë e administratorëve të falimentimit.

Praktika e falimentimit mund të vetë-rregullohet, përmes një agjencie të pavarur, ose përmes një njësie në Ministrinë e Drejtësisë.¹⁴ Vendet tjera ndërmarrin mënyra të ndryshme për rregullimin e praktikës së falimentimit. Kanadaja dhe Serbia kanë agjenci të specializuara, Mbretëria e Bashkuar ka vetë-rregullim të lidhur me disa rregulla, ndërsa Afrika e Jugut nuk ka rregullore të imponuar.¹⁵ Në ekonominë e vogël të tregut në Kosovë, asnjë rregullim ose vetë-rregullim nuk do të ishte aq efektiv sa rregullimi i qeverisë në promovimin dhe avancimin e praktikës së falimentimit. Përderisa një agjenci e pavarur mund të përqendrohet vetëm në mbikëqyrjen dhe monitorimin e një cilësie të lartë, do të ishte e kushtueshme të mirëmbahet, dhe kjo bie në kundërshtim me reformën e vazhdueshme të administratës publike për të zvogëluar numrin e agjencive të pavarura.

Fuqizimi i një njësie në Ministrinë e Drejtësisë do të siguronte një koordinim më të mirë institucional nga politike bërësit për falimentimin. Njësia do të mirëmbante funksione të raportimit, mbikëqyrjes dhe funksione të tjera rregullatore dhe disiplinore. Një entitet i tillë gjithashtu duhet të kërkojë përgjegjësi shtesë lidhur me njohjen e Kualifikimeve të Administratorëve të Falimentimit të marra nga shoqata të ndryshme të huaja dhe vendase, për të cilat aktualisht nuk ka ndonjë procedurë të caktuar. Në të ardhmen, me rritjen e praktikës së falimentimit dhe numrit të rasteve, njësia gjithashtu mund të shndërrohet në një agjenci të pavarur. Rregullimi dhe mbikëqyrja e falimentimit është parashikuar

¹⁴ “Options for IP regulation – what works best”, presentation from Zolfo Cooper, https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/b2ff67004b713d63b473b56eac26e1c2/Cooper_eng.pdf?MOD=AJPERES&CA_CHEID=b2ff67004b713d63b473b56eac26e1c2

¹⁵ See: IFC Kosovo Country Report on Insolvency: Review of Legal and Institutional Insolvency Framework in Kosovo

gjithashtu në Parimet e Bankës Botërore mbi Falimentimin Efektiv dhe të Drejtat e Kreditorit/Debitorit, dhe Parimet e Zyrës së Falimentimit të BERZH-it.¹⁶

Një mekanizëm i tillë është në funksion të një procesi shumë të mirë të falimentimit i bazuar në parime, legjislacion përkatës në fuqi dhe standarde ndërkombëtare. Përpos kësaj funksioni i këti mekanizmi do të jetë edhe përball profesionalizmit, disiplinimit dhe përgjegjësisë së Administratorëve Falimentues. Sigurisht që kujdesi duhet që të jetë në raport me pavarësinë e punës së Administratorëve Falimentues dhe Gjykatës, ku duhet të eliminohet çfarëdo ndërhyrje apo interferim në aspektin përmbajtësor dhe mënyrën e falimentimit.

Përpos kësaj, ky mekanizëm do duhet që të ketë në funksion edhe kompetencë grumbullimin, vlerësimin dhe analizën e çdo rasti në raport me faktorët e falimentimit të ndërmarrjeve. Sigurisht që këto të dhëna që i gjeneron ky mekanizëm do të jenë në funksion të përmirësimit të kushteve të caktuara apo legjislacion të caktuar e i cili ka qenë faktor që ka dërguar ndërmarrjet në falimentim. Një mekanizëm i tillë mungon, andaj edhe të dhëna të sakta sa i përket faktorëve që shkaktojnë falimentim mungojnë. Mungesa e këtyre të dhënave, nuk mundëson që të ndërhyhet dhe të evitohen, nëse ato mund të evitohen qoftë përmes ndryshimit të politikave ekonomike, fiskale, juridike etj. Andaj ky mekanizëm duhet të shikohet dhe të vlerësohet si i dobishëm dhe është në funksion të parandalimit sa më të madh të ndërmarrjeve që falimentojnë.

Veprimi i propozuar: futja në bazën ligjore për fuqizimin e një njësie mbikëqyrëse do të ishte me interes dhe do të jetë në funksion të avancimit dhe zhvillimit të fushës së falimentimit, duke përfshirë rishikimin e kriterëve për licencim dhe rilicencim dhe trajtimin e të huajve që aplikojnë për tu përfshirë në regjistrin e administratorëve falimentues.

Ndryshimet e propozuara më sipër do të thjeshtonin dhe futnin risitë shtesë në Ligjin ekzistues të falimentimit. Përderisa ndryshimet e propozuara promovojnë të drejtat dhe pjesëmarrjen e kreditorëve, ato gjithashtu ofrojnë mundësi për bizneset e ndershme sepse shumë herë "dështimi i Shoqërisë Tregtare nuk është për shkak të paaftësisë së sipërmarrësve, por të rrethanave të jashtme."¹⁷ Ndryshimet e propozuara gjithashtu inkurajojnë fillimin e procedurave dhe maksimizojnë kthimet e kreditorëve. Në përgjithësi, ndryshimet e propozuara kanë për qëllim rritjen e efektivitetit të regjimit të falimentimit

¹⁶ See <http://pubdocs.worldbank.org/en/919511468425523509/ICR-Principles-Insolvency-Creditor-Debtor-Regimes-2016.pdf>; file:///C:/Users/Admin/Downloads/ioh_principles.pdf

¹⁷See: file:///C:/Users/Admin/Downloads/second_chance_final_report_en.pdf

në Kosovë në mënyrë që të rrisin besimin e bizneseve për të inkurajuar një numër më të madh të aplikimeve të falimentimit.

(f) Përcaktimi i qartë i dispozitave procedurale dhe atyre materiale si dhe përcaktimi i qartë i kompetencës së gjykatës

Në përmbajtje të legjislacionit përkatës në fuqi, i njëjti përmban dispozita procedurale përmes së cilave synohet të rregullohet aspekti procedural i falimentimit. Përpos kësaj, posedon edhe dispozita materiale përmes së cilave synohet që të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet për kreditorët, debitorin, gjykatën dhe administratorët falimentues. Forma se si i përmban Ligji këto dispozita, krijojnë probleme në praktik tek pjesa e zbatimit. Me qëllim të eliminimit të këtyre problemeve në praktik, sigurisht se është e nevojshme që të ketë ndryshim. Ndryshimi duhet që të jetë në atë formë që të jenë të përcaktuar qartë dispozitat procedurale dhe ato materiale si dhe të ketë ndarje të qartë brenda Ligjit dhe jo të jenë një përzierje siç janë tani. Andaj një rregullim dhe sistematizim i kësaj pjese është në funksion të kuptimit më të lehtë dhe zbatimit më efikas nga gjykata, debitori dhe kreditorët si dhe administratori falimentues.

Edhe sa i përket kompetencës së Gjykatës është me rëndësi që të ndryshohet legjislacioni dhe i njëjti të jetë në harmoni me ndryshimet e fundit me rastin e themelimit të Gjykatës Komerciale. Në kuadër të kësaj është më interes që të përcaktohet edhe kufizimi sa i përket të drejtës për ankesë dhe mjete të jashtëzakonshme juridike. Rregullimi i kësaj pjese do të jetë në funksion të zhvillimit më efikas të procedurës së falimentimit, qasje në të drejtën për ankesë dhe sigurinë juridike për kreditorët dhe debitorin.

Me rëndësi dhe shumë më interes është edhe rregullimi i një pjese tjetër dhe ajo që i referohet situatës kur në të njëjtën kohë kemi fillim të procedurës së falimentimit dhe të njëjtën kohë kundër debitorit është ngritur Padi për konteste pronësore, kompensim dëmi apo tjetër. Duke pas për bazë se kemi të bëjmë me masën pasurore të ndërmarrjes, kur kemi në të njëjtën kohë zhvillim të dy procedurave, a duhet të përcaktohet që njëra procedurë të pezullohet apo mund të vazhdojnë në të njëjtën kohë. Nëse konsiderohet se duhet ti jepet përparësi njëres nga procedura, duhet që të përcaktohet saktë kur një procedurë mundet me u pezulluar dhe cilat kushte duhet të plotësohen. Kjo është me interes që të përcaktohet, për faktin se nuk është e rregulluar dhe është me interes juridik që të rregullohen se sigurisht do të ketë situata që në praktik do të ballafaqohet gjykata.

(g) Falimentimi ndërkombëtar

Kjo pjesë është me rëndësi të madhe që të përcaktohet saktë dhe të rregullohet, kjo për faktin se globalizmi na vije në situatë që edhe Kosova të ballafaqohet me situata të tilla. Kjo pjesë duhet të përcaktoj saktë kur një ndërmarrje vendore mund të jetë pjesë e falimentimit në një shtet tjetër dhe ajo që vendoset të prodhoj efekt juridik në vendin tonë. Përpos kësaj duhet që të jetë e përcaktuar edhe pjesa kur i referohet situatës që një kreditor i Kosovës ka interes për një procedurë të falimentimit që është duke u zhvilluar në një shtet tjetër dhe efekti juridik i vendimmarrjes në vendin tonë. Me interes është që në këtë pjesë të përcaktohen standarde ndërkombëtare e për të cilat Kosova ka obligim që ti zbaton dhe inkorporon në legjislacionin përkatës në fuqi. Përpos kësaj pjesë me rëndësi është edhe përcaktimi i parimit të reciprocitetit në raport me falimentimin me shtetet tjera.

(h) Hartimi i kornizës ligjore për falimentimin e ndërmarrjeve publike

Kjo pjesë është shumë e rëndësishme që të rregullohet sepse aktualisht është e pamundur që të zhvillohen procedurat e falimentimit për ndërmarrjet publike në mungesë të kornizës ligjore, gjë që bllokton procesin dhe pamundëson futjen në falimentim të ndërmarrjeve publike.

(i) Harmonizimi i kornizës ligjore të falimentimit me Ligjin për Shoqëritë Tregtare

Është e domosdoshme që të bëhet harmonizimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare me Ligjin për Falimentimin, ashtu që të rregullohen procedurat e shuarjes administrative të biznesit dhe të njëjtat të mos bien ndesh me dispozitat e ligjit për falimentimin, me fokus të vecantë në nevojën që shuarja administrative të jetë e kontrolluar dhe të mos dëmtojë kreditorët. Shoqëria Tregtare duhet të kalojë nëpër procedurat e falimentimit para shuarjes.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe Vlerësimi i Ndikimeve të Ardhshme

